



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*  
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Nr. 125/2025  
Datë: 10/09/2025

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare Nr.7/01 Mars 2019), dispozitat e nenit 65 të Ligjit Nr. 08/L -197 për Zyrtarët Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21/18 shtator 2023) dhe Ligji Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik si dhe neni 11 i Rregullores Nr.02/2024 për transferimin e nëpunësve civil, Sekretarja e Përgjithshme nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për transferimin e përhershëm për interes të institucionit**

1. Znj. Besa Krasniqi, Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Profesione të Lira në Departamentin për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika, transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në pozitën: Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Znj. Besa Krasniqi, Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Profesione të Lira në Departamentin për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në pozitën: Zyrtare e Lartë

Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe interesave të institucionit për menaxhim sa më të mirë të punës në divizionin që transferohet.

Nga sa u tha më lartë Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë në ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi siç parashihet me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ankesa i dërgohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

  
Anita KALANDERI  
Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i'u dërgohet;

- Znj. Besa Krasniqi;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar;
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Departamentit për Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Arkivit të MD-së.